



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



AD/GJTHPR/45/21

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga F.B, ndaj gjyqtarit N.Q, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 20.01.2021 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga pala F.B, ndaj gjyqtarit N.Q, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate - Kryetarja e Gjykatës A.Sh R me datë 21.12.2021 ka pranuar ankesën nga pala F.B ndaj gjyqtarit N.Q me kërkesë që Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë të kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore.

Parashtruesi i ankesës F.B, në ankesën e ushtruar pretendon se gjyqtari i çështjes civile me veprimet, përkatësisht mos veprimet e tij e prolongon çështjen dhe nuk ndërmerr asnjë veprim të mëtejshëm në drejtim të vazhdimit të shqyrtimit dhe zgjidhjes meritore të kësaj çështje. Sipas palës duke parë mos veprimet e gjyqtarit dhe duke vuajtur dëmet enorme që po shkaktohen për shkak të caktimit të masës së sigurimit në pronën e tij, ju ka drejtuar gjykatës me disa parashtresa. Është theksuar më tej në ankesë, se gjyqtari i çështjes ka treguar qasje të pabarabartë, si në raport me palën kundërshtare ashtu edhe në raport me qytetarët, duke shkelur dispozitat ligjore e që manifestohen në dy drejtime: në trajtimin e lëndës, si të shqyrtimit meritore ashtu dhe të masës së sigurimit, si dhe mos informimit në raport me ecurinë e çështjes. Po ashtu është theksuar në ankesë se është duke ju bërë trajtim i pabarabartë lidhur me lëndën C.nr.408/2016 në raport me lëndët që janë duke u trajtuar të natyrës së njëjtë, lëndë kompensim dëmi të vitit 2016. Pala ankuese pretendon se ka shkelje disiplinore sipas nenit 5, par. 1, nën-par.1.2 dhe par.2, nën-par. 2.1, 2.2 dhe 2.7, të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjyqtari i çështjes civile ka deklaruar se, pas pranimit të lëndës, ka gjetur se objekt kontesti në këtë çështje kontestimore nuk është vetëm kompensimi i dëmit, siç pretendon pala ankuese, por

janë dy çështje juridike: Anulimi i kontratës mbi ndërtimin dhe kompensimi i dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës. Prandaj, me qenë se çështja juridike në këtë rast është edhe anulimi i kontratës mbi ndërtimin, e cila është përcaktuese për çështjen e kompensimit të dëmit dhe për të dy kërkesat e palëve duhet të vendoset me një aktgjykim, pasi që procedura kontestimore është bashkuar, kjo lëndë nuk është vënë në punë për shkak të mos prioritetit ligjor që ka në raport me lëndët tjera. Në anën tjetër propozimet e paditësve – kundër të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit (Fejzullah Beha dhe Valbona Mala) të dorëzuara në gjykatë gjatë vitit 2021, gjyqtari nuk i ka vlerësuar si urgjente për faktin se të njëjtat mbështeten në rrethana të njëjta faktike dhe prova në bazë të të cilave është caktuar masa e sigurisë me aktvendimin C.nr.408/16 të datës 27.07.2016 dhe është refuzuar propozimi për shfuqizimin e masës së sigurisë, dhe me aktvendimin Ac.nr.2400/17, është refuzuar ankesa dhe është vërtetuar Aktvendimi i GJTHP nga Gjykata e Apelit. Andaj, edhe pretendimet e ankuesit se gjyqtari i çështjes ka trajtuar në mënyrë jo të barabartë ankuesin në raport me palën kundërshtarë por edhe me palët e treta, nuk qëndrojnë, sepse nga gjyqtari aktual nuk është ndërmarr asnjë veprim në këtë lëndë, kurse lëndët e përfunduara deri me tani kanë pasur prioritet ligjor në raport me lëndën e ankuesit. Nëse ankuesi dyshon në paanësinë e gjyqtarit, i njëjti konform Kreut III të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka mundur të paraqes kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit, për të cilën kërkesë vendos Kryetari i Gjykatës.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës dhe deklarimit të gjyqtarit ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për shkelje disiplinore të gjyqtarit N.Q.

Referuar shkresave të lëndës lidhur me rastin e iniciuar sipas padisë së paditësit N.Z.B. Bashkimi kundër të paditurve F.B dhe V.M, gjykata ka vendosur për masën e sigurisë me aktvendim C.nr.408/16 të datës 27.07.2016. Gjykata me aktvendimin C.nr.408/16 të datës 18.09.2018 duke vepruar sipas propozimit të të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit ka bashkuar lëndën me numër C.nr.508/14 me lëndën C.nr.408/16.

Autoriteti i kësaj gjykate ka gjetur se gjykata përkatësisht gjyqtarët e ngarkuar me këtë lëndë kanë kryer veprime procedurale të nevojshme dhe urgjente në drejtim të procesit kontestimor dhe kanë vendosur propozimet e natyrës urgjente duke vendosur masën e sigurisë në paluajtshmërin lëndore sipas Aktvendimit C.nr.408/16, i cili Aktvendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit. Bazuar në numrin e madh të lëndëve që është e ngarkuar gjykata përkatësisht gjyqtari i rastit të kësaj lënde, vlerësohet se gjyqtari nuk e ka prolonguar procedimin dhe vendosjen e kësaj lënde, por shkak i vonës në procedim të kësaj çështje është faktori objektiv (ngarkesa e gjyqtarit me numër të madh të lëndëve). Në anën tjetër propozimet e paditësve – kundër të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit (F.B dhe V.M) të dorëzuara në gjykatë gjatë vitit 2021, gjyqtari nuk i ka vlerësuar si urgjente për faktin se të njëjtat mbështeten në rrethana të njëjta faktike dhe prova në bazë të të cilave është caktuar masa e sigurisë me aktvendimin C.nr.408/16.

Në çështjen e theksuar se është duke ju bërë trajtim i pabarabartë në raport me lëndët që janë duke u trajtuar të natyrës së njëjtë, lëndë kompensim dëmi të vitit 2016, lidhur me këtë çështje objekt kontesti në këtë çështje kontestimore nuk është vetëm kompensimi i dëmit, siç pretendon pala

ankuese, por janë dy çështje juridike: Anulimi i kontratës mbi ndërtimin dhe kompensimi i dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës. Prandaj, për të dy kërkesat e palëve duhet të vendoset njëkohësisht nga gjykata, pasi procedura kontestimore është bashkuar.

Në dispozitat e përcaktuara në ankesë në pikat 10.3, 10.4, 10.5, 10.6, .10.7, 10.8 janë pretendime për të cilat gjyqtari ende nuk ka marr veprime në këtë lëndë siç është theksuar edhe më lartë nuk ka pasur qasje apo kontakt me palën tjetër në procedurë dhe nuk mund të konsiderohet se gjyqtar ka vepruar në kundërshtim të këtyre dispozitave. Ndërsa në dispozitat e përcaktuara në pikat 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, përkatësisht referuar dispozitave në pikës 11.1 dhe 11.2 gjyqtari i çështjes nuk ka vepruar apo nuk ka marr veprime konform këtyre dispozitave për shkaqe objektive, për dispozita të tjera të përcaktuara në pikat në vazhdim kanë të bëjnë me çështje procedurale e që nuk konsiderohen shkelje disiplinore.

Ndërsa lidhur me pretendimet e palës ankuese, se gjyqtari N.Q ka qenë i njëanshëm në veprimet e tij gjatë procedurës gjyqësore, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e parashtresit të ankesës dhe vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë. Po ashtu nuk janë vërtetuar pretendimet për sjellje jo adekuate të gjyqtarit, respektivisht mos trajtim të pabarabartë të palëve në procedurë dhe çështja e mos procedim me kohë të kësaj lënde sipas dispozitave të LPK-së ka ndodh për shkaqe objektive dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par. 2, nën-par. 2.1, 2.2, 2.7 dhe të par. 1.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, lidhur me parashtesën e ushtruar, në bazë të dhënave të përshkruara më lartë nuk ka gjet bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtuar KGJK-së Kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
AD/GJTHPR/45/21, më datë 20.01.2021

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë